

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8299
E mërkurë, 13 maj 2026
Çmimi 0.50 €

Zgjedhjet e 7 qershorit:
Mbi 59 mijë aplikime për
regjistrim nga diaspora

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

IKD KRITIKON LEGJISLATURËN E DHJETË: PROCEDURA TË PËRSHPEJTUARA, DEBAT I KUFIZUAR DHE MUNGESË TRANSPARENCE

FAQE 4-5



Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me mbështetjen e Fondacionit "Rockefeller Brothers", ka publikuar raportin "Monitoruesi i Legjislaturës së X", përmes të cilit është bërë një analizë e funksionimit të Kuvendit

të Kosovës gjatë kësaj legjislature. Në prezantimin e raportit, hulumtuesi i lartë i IKD-së, Naim Jakaj, theksoi se mbi 40 për qind e seancave të Kuvendit kanë qenë seanca të jashtëzakonshme që, sipas tij, tregojnë për një orientim të

shumicës parlamentare drejt menaxhimit të agjendës parlamentare përmes procedurave të përshpejtuara, duke reduktuar hapësirën për debat substancial parlamentar dhe shqyrtim të mirëfilltë të projektligjeve

AKTUALE



**TRUMPI NUK I NDAHET IRANIT:
JAM 100 % I BINDUR SE
ATA NUK DO TË PRODHONJË
MË ARMË BËRTHAMORE F. 2**

**KOSOVA KRYESON RAJONIN
ME PËRQINDJEN E TË RINJVE
NË BURGJE. PSE? F. 6**

**KALLAS: ZGJEDHJET
NË KOSOVË VONOJNË DIALOGUN
PRISHTINË - BEOGRAD F. 7**

EKONOMI



**PAS PROTESTËS SË FERMERËVE,
QEVERIA SHTON KONTROLLET NË
SEKTORIN E QUMËSHITIT F. 8**

**NGA BERLINI, THIRRJE PËR
KOSOVËN DHE RAJONIN: MË
SHUMË BASHKËPUNIM PËR
PUNËSIM DHE ZHVILLIM F. 8**

SPORT



**FFK-ja ARANZHON DY NDESHJE
MIQËSORE PËR KOMBËTAREN E
KOSOVËS F. 11**



**INTERVISTË
ME BARDHYL
MAHMUTIN:
JAM I SIGURT
NË PAFAJËSINË E
PERSONALITETEVE
EMBLEMATIKE
TË UÇK-së F. 3**



**AVOKATËT
BRITANIKË I
PËRGJIGJEN
SPECIALES:
LEGJITIMITETI
VARET NGA AFTËSIA
PËR T'I ZBATUAR
STANDARDET
NË PRAKTIKË F. 5**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-JA KËRKON NGA SHTETET E BALLKANIT PERËNDIMOR QË TË HARMONIZOHEN ME VLERAT E PËRBASHKËTA

BRUKSEL, 12 MAJ - Ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhanë mbështetje politike për thellimin e bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor në çështjet e sigurisë së jashtme dhe mbrojtjes.

Në sesionin e mëngjesit të takimit ministror më 11 maj, kryediplomatët e shteteve anëtare të bllokut u takuan me gjashtë homologët e tyre nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Kosova në këtë takim u përfaqësua nga ministri në detyrë i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Glauk Konjufca.

Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, sqaroi në fund të takimit se Brukseli është i gatshëm t'i mbështesë vendet e rajonit në përpjekjet për luftimin e kërcënimeve hibride dhe dezinformatave si dhe përmes

përdorimit më të madh të Instrumentit Evropian të Paqes për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të partnerëve.

Megjithatë, ministrat evropianë u kërkuan vendeve të rajonit që të harmonizohen me vlerat e përbashkëta. "Vendet anëtare shprehën prirjen që të gjitha vendet të ecin në rrugën evropiane dhe të jenë plotësisht të harmonizuara me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, sepse në këto kohë gjeopolitike në të cilat jetojmë, kjo nuk është vetëm përbushje formale e obligimeve por, në fakt, tregon nëse e shohim botën në të njëjtën mënyrë", deklaroi Kallas.

Ajo vuri në pah se jo të gjitha vendet e rajonit janë plotësisht të harmonizuara me politikën e sanksioneve të Bashkimit Evropian. "E dimë shumë mirë se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë të ndryshme



dhe kanë pikëpamje të ndryshme për çështje të caktuara, gjë që në masë të madhe reflektohet në harmonizimin me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë", shtoi Kallas. Shefja e diplomacisë evropiane

theksoi se partneriteti zhvillohet në të dy drejtimet, prandaj nga vendet e rajonit priten reforma të mëtejshme, respektimi i sundimit të ligjit, si dhe harmonizimi i qartë me politikën e jashtme të BE-së.

Nga vendet e rajonit, Serbia, që aspiron të bëhet pjesë e BE-së, përkundër thirrjeve të Brukselit, ka refuzuar t'u bashkohet sanksioneve të bllokut evropian ndaj Rusisë për shkak të luftës në Ukrainë.

QALIBAF: SHBA-JA S'KA ALTERNATIVË TJETËR PËRVEÇSE T'I PRANOJË KUSHTET E IRANIT

TEHRAN, 12 MAJ - Kryenegociatori i Iranit, Mohammad Baqer Qalibaf, tha se Shtetet e Bashkuara "nuk kanë alternativë" tjetër përveçse ta pranojnë kundërpropozimin e fundit të Teheranit për përfundimin e luftës. "Nuk ka alternativë përpos që të pranohet e drejta e popullit iranian ashtu siç është përshkruar në propozimin 14-pikësh", tha Baqer në X më 12 maj, i cili njëherësh është edhe kryetar i Parlamentit iranian. "Çdo qasje tjetër do të jetë krejtësisht jopërfshirëse, asgjë më shumë sesa një dështim i ri". Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme iraniane, Esmail Baqaei, tha gjatë një konference për medie më 11 maj se përgjigja e Teheranit - që i është dërguar



ShBA-së përmes ndërmjetësit, Pakistanit, më 10 maj - përfshin ndaljen e luftës, heqjen e bllokadës së ShBA-së në

Ngushticën e Hormuzit, lirim të aseteve të ngrira të Iranit dhe "vendosjen e sigurisë në rajon dhe Liban".

Presidenti amerikan Donald Trump e ka quajtur kundërpropozimin e Teheranit "krejtësisht të papranueshëm". "Sa më gjatë ata i zvarrisin këmbët, më shumë do të paguajnë taksapaguesit amerikanë për këtë çështje", shtoi Baqer.

Një ditë më parë presidenti Trump foli edhe për armëpushimin me Iranin që është në fuqi që nga 8 prilli, duke thënë se marrëveshja ishte në prag të kolapsimit, duke shtuar se po e shqyrton mundësinë e rinisjes së shoqërimit të anijeve në Ngushticën e Hormuzit, teksa po synon të arrijë "fitore të plotë" në luftën që nisi më 28 shkurt.

Duke folur për gazetaret në Shtëpinë e Bardhë më 11 maj, Trumpi tha se armëpushimi është "jashtëzakonisht i dobët". "Do të

thosha se ky është një nga [armëpushimet] më të dobëta për momentin, është në aparate mbështetëse për jetë", tha ai. "Do të thosha se armëpushimi është në mbështetje masive për jetë." Udhëheqësi amerikan më vonë tha në një intervistë për Fox News se po shqyrtonte rifillimin e operacionit për shoqërimin e anijeve nëpër ngushticë, megjithëse një vendim përfundimtar për këtë çështje ende nuk është marrë.

Operacioni për shoqërimin e anijeve nisi më 6 maj, por u ndërpre më pak se dy ditë më vonë. "Ne do të kemi një fitore të plotë", tha Trump, duke shtuar se Teherani mendon se "do të lodhem nga kjo. Do të merrim ose do të jem nën ndonjë presion. Por, nuk ka presion".

TRUMPI NUK I NDAHET IRANIT: JAM 100 % I BINDUR SE ATA NUK DO TË PRODHOJNË MË ARMË BËRTHAMORE

UASHINGTON, 12 MAJ - Presidenti amerikan Donald Trump u shpreh i bindur se Irani do ta ndalojë programin e pasurimit të uranimit dhe do të heqë dorë nga çdo përpjekje për zhvillimin e armëve bërthamore, edhe pse negociatat mes Uashingtonit dhe Teheranit mbeten të tensionuara. Trumpi deklaroi se ShBA-ja mund ta ndalojë Iranin të zhvillojë një program

bërthamor ushtarak. "100 për qind ata do të ndalen", tha ai. Trumpi zbuloi se është personalisht i përfshirë në kontaktet me zyrtarët iranianë gjatë negociatave. "Unë po negocioj me ta", deklaroi presidenti amerikan, duke shtuar se pala iraniane i kishte thënë se "do ta marrim pluhurin", term që ai e përdori për materialin bërthamor. Presidenti amerikan theksoi se

Uashingtoni nuk ndodhet nën presion për të arritur shpejt një marrëveshje me Teheranin. "Nuk do të nxitohemi për asgjë, por po ecim me ritëm të shpejtë", u shpreh Trump. Komentet e tij erdhën një ditë pasi ai deklaroi se armëpushimi mes ShBA-së dhe Iranit ndodhej në një fazë kritike, ndërsa kundërpropozimin e fundit të Teheranit e cilësoi "plotësisht të papranueshëm".



JAM I SIGURT NË PAFAJËSINË E PERSONALITETEVE EMBLEMATIKE TË UÇK-SË

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 MAJ - Çështja e shtyrjes së shpalljes së aktgjykimit nga Dhomat e Specializuara të Kosovës ka ngjallur reagime të shumta. Për këtë çështje kërkuam mendimin edhe të politologut dhe shkrimtarit Bardhyl Mahmuti, i cili gjatë luftës ka qenë përfaqësues politik i UÇK-së.

Në një intervistë të shkurtër për "Epokën e re", ai ka theksuar se asnjëri nga 127 dëshmitarët e prokurorisë të cilët kanë dëshmuar në sallën e gjyqit në Speciale nuk solli asnjë provë të vetme që do t'i vërtetonte akuzat e sajara në Beograd dhe të formësuar në një aktakuzë që mban emrin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës.

Po sipas tij, nga ana tjetër, jemi dëshmitarë të faktit se mbrojtja e të akuzuarve solli personalitete me integritet të njohur ndërkombëtarësh që theu shtyllën kurriore të aktakuzës, duke shpërfaqur publikisht argumente të pakontestueshme për pafajësinë e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit.

Bardhyl Mahmuti ka thënë se është i sigurt në pafajësinë e personaliteteve emblematike të UÇK-së. "Në rastin konkret, unë jam tërësisht i SIGURT në pafajësinë e tyre, sepse gjatë procesit gjyqësor dolën në

shesh argumente të pakontestueshme që çmontuan tërësisht sajaset serbe mbi të cilat prokurorët kishin përpiluar aktakuzën", ka deklaruar përfaqësuesi politik i UÇK-së, Bardhyl Mahmuti.

"Epoka e re": Në kohën kur pritej që e ashtuquajtura Gjykatë Speciale në Hagë ta shpallte vendimin për procesin gjyqësor kundër figurave emblematike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi, ajo e shtyri afatin deri në muajin korrik. Si e shihni këtë shtyrje afati?

Bardhyl Mahmuti: Që nga hapja e procesit gjyqësor më 5 nëntor 2023 e deri në përfundim të dëgjimit të dëshmitarëve të prokurorisë, trupi gjyqësor dhe qytetarët e Kosovës që e kanë ndjekur procesin gjyqësor nëpërmjet medieve, kanë pasur mundësi të konstatojnë se asnjëri nga 127 dëshmitarët e prokurorisë që dëshmuar në sallën e gjyqit nuk solli asnjë provë të vetme që do t'i vërtetonte akuzat e sajara në Beograd dhe të formësuar në një aktakuzë që mban emrin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës. Nga ana tjetër, jemi dëshmitarë të faktit se mbrojtja e të akuzuarve solli personalitete me integritet të njohur ndërkombëtarësh që theu shtyllën kurriore të aktakuzës, duke shpërfaqur



publikisht argumente të pakontestueshme për pafajësinë e z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi. Nëse shtyrja e shpalljes së vendimit është bërë për shkak të nevojës për t'i çmontuar tërësisht dhe hollësisht të gjitha pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës dhe hedhë poshtë të gjitha sajaset serbe për luftën çlirimtare të Kosovës, atëherë mund të gjendet njëfarë "mirëkuptimi" për vazhdimin e mbajtjes padrejtësisht prapa grilave të njerëzve që janë tërësisht të pafajshëm.

"Epoka e re": Personalitete të

shumta dhe struktura politike dhe ato të dala nga lufta çlirimtare kanë shprehur publikisht besimin e tyre të plotë, se udhëheqësit e UÇK-së janë tërësisht të pafajshëm. Në qëndrimin tuaj keni pasur një nuancë dallimi. Si qëndron puna?

Bardhyl Mahmuti: Çështja e "Besimit" është çështje subjektive, ku personi është i bindur për diçka, pa pasur prova objektive. Në rastin konkret, unë jam tërësisht i SIGURT në pafajësinë e tyre, sepse gjatë procesit gjyqësor dolën në shesh argumente të pakontestueshme që çmontuan tërësisht sajaset serbe mbi të cilat prokurorët kishin përpiluar aktakuzën.

Prandaj shpresoj që pafajësia objektive e të akuzuarve në këtë proces politik të konfirmohet nëpërmjet vendimit të trupit gjyqësor. Mund të ndodhë gjithçka, por unë nuk besoj se juristë të lindur dhe të shkolluar në shtetet demokratike do t'i anashkalojnë argumentet e shumta për pafajësinë e të akuzuarve dhe t'i pranojnë për të vërteta sajaset e Shërbimit Sekret të Serbisë. Pra nuk besoj se këta juristë do të pranojnë me vetëdije të plotë të bëhen pjesë e skandalit më të madh dhe të mbeten në analet e historisë si gjyqtarë që përdhosën drejtësinë, duke përligjur sajaset e një pale ndërluftuese kundër palës tjetër.

HAMZA: LIMAJ S'DO TË JETË PJESË E LISTËS SË PDK-SË NË ZGJEDHJET E QERSHORIT

PRISHTINË, 12 MAJ - Kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, tha se Fatmir Limaj dhe Nisma Socialdemokrate nuk do të jenë pjesë e listës garuese të subjektit për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit. Hamza e bëri me dije këtë lajm pas mbledhjes së kryesisë së partisë së tij, duke theksuar se në mbledhje u trajtua kërkesa, përkatësisht letra që kreu i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj - dikur një eksponent i rëndësishëm PDK-së - i dërgoi atij. "Sa i përket garimit në këtë listë, është qëndrimi i përgjithshëm që fillimisht duhet të ndodhë një përkrahje për PDK-në, një vullnet i mirë nga Nisma Socialdemokrate, pastaj në zgjedhjet e ardhshme ne do t'i trajtojmë kur të vijë ato në mënyrën e duhur. Por, kësaj



radhe zoti Limaj nuk do të jetë pjesë e listës së PDK-së", tha Hamza për gazetarët. Hamza tha se në kërkesën që Limaj i dërgoi PDK-së, ai nuk kërkoi që vetë të ishte pjesë e listës garuese. Megjithatë, udhëheqësi i PDK-së tha se presin përkrahjen e Limajt dhe Nismës Socialdemokrate në zgjedhjet e 7 qershorit, duke

theksuar se "jam i bindur që kjo përkrahje do të reflektojë në rritjen e votës për PDK-në". Hamza tha se nuk e përjashton mundësinë që në të ardhmen Nisma Socialdemokrate apo anëtarë të kësaj partie t'i bashkohen subjektit që ai udhëheq. Për zgjedhjet e 7 qershorit - që erdhën pasi deputetët

dështuan të zgjedhin një president të ri - sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve - janë regjistruar 22 subjekte politike dhe tri koalicionet, teksa nëntë subjekte kanë hequr dorë nga garimi si të vetme ose në koalicion.

Në mesin e partive që nuk janë regjistruar për garë zgjedhore është Nisma Socialdemokrate. Belgzim Kamberi nga Instituti Joqeveritar për Politika Sociale "Musine Kokalari" në Prishtinë, i tha më herët Radios Evropa e Lirë se Lëvizja Vetëvendosje do të përfitojë vota shtesë nga mungesa e Nismës në garë. "Nga mospjesëmarrja e Nismës natyrisht që përfiton pushteti, sepse nëse konsiderojmë që Nisma do të kishte hyrë me PDK-në, votat do të shkonin te ky subjekt, tash disa vota, aq sa

janë të Nismës, do të shkrihen", theksoi ai. Sipas tij, në këtë drejtim dëmtohet "opozita në përgjithësi, por edhe PDK-ja në kuptimin e pastër elektoral". Limaj ditë më parë ka deklaruar për televizionin "Dukagjini" se është i interesuar që Nisma Socialdemokrate të shkrihet në PDK. Ndryshe, Nisma Socialdemokrate garoi e vetme në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor 2025. Partia e Limajt mori 15 189 vota, apo 1.59 për qind, duke mos e kaluar pragun prej 5-përqindësh për të hyrë në Kuvend. Ndërkaq, në zgjedhjet parlamentare të shkurtit të vitit 2025, Limaj garoi së bashku me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe nga tetë mandatet e fituara, tre deputetë ishin nga Nisma Socialdemokrate.



AVOKATËT BRITANIKË I PËRSGJIGJEN SPECIALES: LEGJITIMITETI VARET NGA AFTËSIA PËR T'I ZBATUAR STANDARDET NË PRAKTIKË

PRISHTINË, 12 MAJ - Komiteti për të Drejtat e Njeriut i Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit (BHRC) ka dalë me një sqarim/reagim pas reagimit të Gjykatës Speciale për raportin që e publikoi me kërkesën e Avokatit të Popullit.

Dhomat e Specializuara i kanë quajtur të pasakta disa nga interpretimet e raportit të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të Dhomës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit. Por, BHRC-ja ka thënë se ky raport ofron një vlerësim të pavarur paraprak të Dhomave të Specializuara të Kosovës, i cili u hartua me qëllim për ta vlerësuar shkallën në të cilën kjo gjykatë përputhet me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut.

Komiteti ka theksuar se raporti është i realizuar duke vënë theks të veçantë “te pavarësia - pa kontribut nga institucioni që e ka porositur, rishikimi përdor një metodologji doktrinare, të bazuar në shqyrtim dokumentesh, e mbështetur në burime juridike primare, jurisprudencë dhe angazhim të informuar me praktikues ligjorë”. “Megjithëse cilësohet qartë si ushtrim ‘paraprak’, raporti identifikon një sërë

temash thelbësore që janë qendrore për legjitimitetin e drejtësisë penale ndërkombëtare bashkëkohore, përfshirë të drejtat e të akuzuarve, pavarësinë gjyqësore, drejtësinë e provave dhe barazinë e palëve. Në këtë mënyrë, ai i vendos Dhomat e Specializuara të Hagës brenda rendit kushtetues të Kosovës dhe kornizës më të gjerë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat janë të inkuorpuara drejtpërdrejt në ligjin e Kosovës”, është thënë në reagimin e BHRC-së.

BHRC-ja ka theksuar se raporti gjithashtu “e vendos krijimin e Gjykatës Speciale në kontekstin e trashëgimisë së kontestuar politike dhe historike të konfliktit në Kosovë 1998-1999 dhe akuzave të mëvonshme për krime të kryera nga anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai thekson natyrën ‘sui generis’ të gjykatës: formalisht një institucion vendor i krijuar sipas ligjit të Kosovës, por i përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtarë, i financuar dhe i ndikuar nga aktorë ndërkombëtarë, dhe me seli në

Hagë. Ky dizajn hibrid dhe në disa aspekte kontradiktor krijon sfida të veçanta, veçanërisht në lidhje me legjitimitetin, llogaridhënien dhe marrëdhënien midis standardeve ndërkombëtare dhe traditave juridike vendore. BHRC thekson se fokusi i ngushtë i KSC-së tek ish-udhëheqësit e UÇK-së, trupi gjyqësor ekskluzivisht ndërkombëtar dhe mbështetja në financim dhe mekanizma emërimi të jashtëm janë bërë burime të debatit të vazhdueshëm, duke ngritur pyetje si për perceptimin, po ashtu edhe për realitetin e pavarësisë dhe paanshmërisë”. Në këtë kontekst, BHRC-ja ka thënë se raporti ofron një sërë vëzhgimesh paraprake të strukturuar mbi aspekte kyçe të kornizës ligjore dhe praktikës së Dhomave të Specializuara, përfshirë lirinë e përkohshëm, pavarësinë gjyqësore, pranueshmërinë e provave dhe barazinë e palëve. “Ai konstaton se, megjithëse korniza ligjore formale e Dhomave të Specializuara është përgjithësisht e fortë dhe në shumë aspekte e përputhshme me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në zbatimin praktik

shfaqen shqetësime të rëndësishme. Këto përfshijnë pengesa strukturore për lirinë e përkohshëm, boshllëqe në mekanizmat për kundërshtimin e emërimeve gjyqësore dhe vendimeve administrative, tensione të krijuara nga praktikat e provave (veçanërisht lidhur me materiale të paverifikuara ose të siguruar nga burime të jashtme), si dhe pabarazi në burime dhe procedura që ndikojnë në mbrojtje. Raporti nuk synon të nxjerrë përfundime përfundimtare, por identifikon fusha me rrezik të mundshëm dhe rekomandon shqyrtim të mëtejshëm, duke theksuar se legjitimiteti afatgjatë i Dhomave të Specializuara do të varet jo vetëm nga respektimi formal i standardeve ligjore, por edhe nga aftësia për t'i zbatuar ato në praktikë”, është thënë në këtë reagim.

Në dritën e këtyre gjetjeve, raporti paraqet një sërë rekomandimesh të synuara për forcimin e drejtësisë, transparencës dhe legjitimitetit institucional të Dhomave të Specializuara. Ndër më kryesoret, sipas BHRC-së, janë propozimet për ndryshimin e kornizës

procedurale për të lejuar kundërshtime kuptimplota ndaj funksioneve administrative dhe gjyqësore të presidentit, si dhe futja e protokolleve të qarta për komunikimet, siç janë informimet diplomatike për të siguruar njoftim, transparencë dhe, kur është e përshtatshme, pjesëmarrje të mbrojtjes.

BHRC-ja ka rekomanduar gjithashtu shqyrtim më rigoroz gjyqësor të materialeve provuese, veçanërisht kur kontestohet origjina ose zinxhiri i ruajtjes së tyre, si dhe transparencë më të madhe mbi marrëdhëniet me shtetet financuese dhe aktorë të tjerë të jashtëm.

Në fund, raporti ka theksuar nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe të pavarur të proceseve gjyqësore, duke e identifikuar atë si thelbësor për vlerësimin e ndikimit kumulativ të praktikave procedurale, sidomos në lidhje me barazinë e palëve dhe drejtësinë e provave dhe për sigurimin që Dhomat e Specializuara t'i përmbushin standardet e larta të drejtësisë të kërkuara si nga korniza kushtetuese e Kosovës, ashtu edhe nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut.

IKD KRITIKON LEGJISLATURËN E DHJETË: PROCEDURA TË PËRSHPEJTUARA, DEBAT I KUFIZUAR DHE MUNGESË TRANSPARENCE



Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me mbështetjen e Fondacionit "Rockefeller Brothers", ka publikuar raportin "Monitoruesi i Legjislaturës së X", përmes të cilit është bërë një analizë e funksionimit të Kuvendit të Kosovës gjatë kësaj legjislature. Në prezantimin e raportit, hulumtuesi i lartë i IKD-së, Naim Jakaj, theksoi se mbi 40 për qind e seancave të Kuvendit kanë qenë seanca të jashtëzakonshme që, sipas tij, tregojnë për një orientim të shumicës parlamentare drejt menaxhimit të agjendës parlamentare përmes procedurave të përshpejtuara, duke reduktuar hapësirën për debat substancial parlamentar dhe shqyrtim të mirëfilltë të projektligjeve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MAJ - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me mbështetjen e Fondacionit "Rockefeller Brothers", ka publikuar raportin "Monitoruesi i Legjislaturës së X", përmes të cilit është bërë një analizë e funksionimit të Kuvendit të Kosovës gjatë kësaj legjislature, duke trajtuar mënyrën e funksionimit parlamentar, procesin legjislativ, mbikëqyrjen parlamentare, transparencën institucionale dhe respektimin e standardeve kushtetuese e demokratike.

Në prezantimin e raportit, hulumtuesi i lartë i IKD-së, Naim Jakaj, theksoi se mbi 40 për qind

e seancave të Kuvendit kanë qenë seanca të jashtëzakonshme që, sipas tij, tregojnë për një orientim të shumicës parlamentare drejt menaxhimit të agjendës parlamentare përmes procedurave të përshpejtuara, duke reduktuar hapësirën për debat substancial parlamentar dhe shqyrtim të mirëfilltë të projektligjeve. Sipas tij, kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e procesit legjislativ dhe në rolin mbikëqyrës të Kuvendit ndaj institucioneve ekzekutive.

Raporti evidenton se gjatë kësaj legjislature janë miratuar një numër i konsiderueshëm ligjesh me procedura të përshpejtuara, shpesh pa konsultime të mjaftueshme publike dhe pa

trajtim adekuat të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, shoqërisë civile apo opozitës parlamentare.

Në raport theksohet se përdorimi i shpeshtë i procedurave emergjente ka krijuar vështirësi në garantimin e standardeve të transparencës dhe gjithëpërfshirjes në procesin ligjvënës.

Po ashtu, në raport trajtohet mënyra e formimit të qeverisë, për të cilën IKD ka vlerësuar se është zhvilluar me mungesë transparence dhe me debat të kufizuar parlamentar.

Sipas të gjeturave të raportit, opozita ka pasur aktivitet minimal gjatë seancës për votimin e qeverisë, duke ndikuar në dobësimin e kontrollit parlamentar dhe llogaridhënies demokratike ndaj ekzekutivit.

Një pjesë e rëndësishme që përmendet në raport ka të bëjë me respektimin e aktgjyqimeve të Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe ndikimit të saj në procesin legjislativ.

IKD ka ngritur shqetësimin për mosmiratimin e amendamentit që synonte zbatimin e aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me pagesën e përvojës së punës për zyrtarët publikë. Sipas raportit,

moszbatimi i aktgjyqimeve të Kushtetueses mbetet një nga problemet më serioze në funksionimin demokratik të institucioneve dhe në garantimin e sundimit të ligjit.

Më tutje, raporti nxjerr në pah edhe nivelin e angazhimit të deputetëve në punën parlamentare.

Sipas të dhënave të paraqitura nga IKD, 26 deputetë nuk kanë mbajtur asnjë deklaratë parlamentare gjatë gjithë legjislaturës që, sipas IKD-së, ngre shqetësime serioze për ushtrimin efektiv të mandatit të deputetit dhe përfaqësimin e interesit qytetar në Kuvend.

Në panelin diskutues të organizuar pas prezantimit të raportit, deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Arben Mustafa, deklaroi se shumica parlamentare ka qenë më shumë e fokusuar në përgatitje për zgjedhje sesa në një agjendë serioze shtetërore dhe legjislative. Sipas tij, gjatë gjithë legjislaturës janë përsëritur të njëjtat premtime politike, ndërsa rezultatet konkrete në shumë sektorë kanë munguar.

Ndërkaq, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ilir Kërçeli, deklaroi se shumica parlamentare ka vepruar me ritëm të shpejtë për shkak të nevojës për vendimmarrje

efikase dhe jo për të shmangur demokracinë parlamentare. Ai theksoi se dinamika e zhvillimeve politike dhe nevoja për adresimin e çështjeve të rëndësishme shtetërore kanë kërkuar procedim më të shpejtë të agjendës parlamentare.

Po ashtu, deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, deklaroi se kjo legjislaturë "ka nisur dhe ka përfunduar mbrapsht", duke kritikuar mungesën e bashkëpunimit politik, polarizimin institucional dhe mënyrën e menaxhimit të proceseve parlamentare gjatë mandatit.

Në përfundim, IKD vlerësoi se legjislatura e dhjetë është karakterizuar nga një nivel i lartë i dominimit të agjendës nga shumica parlamentare, përdorim i shpeshtë i procedurave të përshpejtuara, debat i kufizuar parlamentar dhe sfida të vazhdueshme në raport me respektimin e standardeve kushtetuese dhe demokratike.

Përmes këtij raportit, IKD ka bërë thirrje që legjislaturat e ardhshme të garantojnë më shumë transparencë, debat parlamentar substancial, respektim të aktgjyqimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe një rol më aktiv të deputetëve në ushtrimin e funksionit të tyre kushtetues dhe përfaqësues.

Zgjedhjet e 7 qershorit: Mbi 59 mijë aplikime për regjistrim nga diaspora

PRISHTINË, 12 MAJ - Është duke vazhduar periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, e cila ka filluar më 6 maj dhe do të përfundojë më 17 maj.

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valmir Elezi, ka bërë me dije për "Epokën e re" se deri më tani

kanë pranuar mbi 59 mijë aplikime. "Në bazë të të dhënave, nga fillimi i këtij procesi dhe deri më tani (e martë, 12 maj 2026, ora 10:00, përmes platformës elektronike <http://diapsora.kqz-ks.org> janë pranuar 59 415 kërkesa për regjistrim, prej të cilave

janë aprovuar 49 493, ndërsa 4 944 të tjera janë refuzuar dhe 4 957 janë në pritje për shqyrtim. Nga 49 493 aplikime të aprovuara, 11 782 shtetas të Kosovës janë regjistruar për të votuar fizikisht në përfaqësi diplomatike, 1 325 janë regjistruar për të dërguar pakon me fletëvotim në kutinë



postare të KQZ-në në Kosovë dhe 36 386 janë regjistruar për

të dërguar pakon me fletëvotim në kutinë postare jashtë Kosovës", ka thënë Elezi. Shtetet me numrin më të madh të votuesve të regjistruar janë: Gjermani (24 624), Zvicër (11 063), Francë (2 172), Suedi (2 058), Austri (1 508) dhe Mbretëri e Bashkuar (1 337), ShBA (1 115) dhe Itali (1 046).

KOSOVA KRYESON RAJONIN ME PËRQINDJEN E TË RINJVE NË BURGJE. PSE?

PRISHTINË, 12 MAJ - Më shumë se çdo i treti i burgosur në Kosovë është nën moshën 30-vjeçare. Të dhënat, të publikuara në fund të prillit në kuadër të Indeksit të Pjesëmarrjes së Rinisë, tregojnë se Kosova ka përqindjen më të lartë të të rinjve në shërbimin korrektues në të gjithë rajonin.

Një vit më herët Kosova ishte e dyta, pas Shqipërisë.

Për dallim nga disa vende të rajonit që ulën përqindjen e të burgosurve nën 30 vjeç gjatë vitit 2024, Kosova shënoi rritje dhe u rendit e para në rajon. Serbia regjistroi përmirësimin më të madh, me rënie nga 34.8 % në 20.6 %.

Për Ferid Murselin nga organizata Demokracia për Zvillim (D4D) - që grumbulloi të dhënat zyrtare për Kosovën për këtë raport - këto shifra nuk tregojnë vetëm për sistemin penal. "Në vendin tonë, çdo ditë themi që 'ky vend ka rini', 'rinia është e ardhmja', por në fakt kjo tregon saktë se ku qëndron rinia, qoftë në dimensionin politik, social ose ekonomik", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

"Burgjet po reflektojnë një problem më të thellë social"

Përveç shkallës së lartë të të rinjve në burgje, Kosova renditet dobët edhe në tregues të tjerë që lidhen me jetën e të rinjve.

Rreth 35 për qind e të rinjve në Kosovë janë jashtë arsimit, punës dhe trajnimeve - niveli më i lartë në rajon.

Kosova ka përqindjen më të lartë në rajon të të rinjve që nuk ndjekin as shkollim, as ndonjë trajnim dhe nuk janë as të punësuar. Me mbi 35 për qind të të rinjve në këtë pozitë, Kosova gjendet larg synimit të vendosur nga Bashkimi Evropian, prej 5.5 për qind të të rinjve aktivë.

Kosova ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së të rinjve në fuqinë punëtore në rajon, dukshëm nën objektivin prej 83 % të Eurostat-it. "Është një

numër shumë i lartë", thotë Murseli. "Nëse ke papunësi të madhe, atëherë ka gjasa më të mëdha që të rinjtë të jenë të përfshirë në faktorë negativë".

Ai argumenton se institucionet duhet të investojnë më shumë në reforma arsimore, orientim në karrierë, shkolla profesionale dhe aktivitete komunitare për të rinjtë. "Duhet të ketë më shumë qendra rinore funksionale, aktivitete sportive, kulturore dhe artistike, në mënyrë që të rinjve t'u ofrohen alternativa pozitive", thotë Murseli.

Edhe sociologja Donika Gashi nga Instituti Musine Kokalari e sheh këtë statistikë si pasojë të faktorëve më të thellë socialë. "Kjo shifër nuk mund të lexohet thjesht si çështje kriminaliteti, por si simptomë e pasigurisë ekonomike, dështimit arsimor dhe marginalizimit social", thotë ajo për Radion Evropa e Lirë. Sipas saj, shumë të rinj hyjnë në konflikt me ligjin pasi nuk arrijnë të gjejnë punë të qëndrueshme, mbështetje psikologjike ose shërbime komunitare. "Nëse një i ri nuk është në punë, nuk është në arsim dhe nuk sheh rrugë për përparim, sistemi e takon shumë vonë, kur ai tashmë ka hyrë në konflikt me ligjin", thotë Gashi.

"Të rinjtë trajtohen si numra"

Radio Evropa e Lirë ka pyetur Ministrinë e Drejtësisë nëse ka ndonjë plan për ta trajtuar këtë fenomen, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje.

Ngjashëm, as Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk i ka dhënë REL-it leje për vizitë në Qendrën Korrektuese për të Mitur, që ndodhet në Lipjan.

Gjatë një vizite para disa viteve, dy të rinj kishin treguar për jetën e tyre brenda mureve të këtij institucioni në izolim. Të dy mezi prisnin lirimin dhe kthimin në shoqëri, por psikologja Fjolla Ibrahim kishte lënë të kuptohet se ai kthim mund të mos jetë shumë



mikpritës. "Sfidat kryesore që hasin ish të burgosurit në riintegrim, janë mospërputhshmëria me personat e tjerë në rrethin ku ata do të jetojnë, gjetja e një pune permanente, e cila sjell të ardhura, shëndeti i tyre mendor pas daljes nga burgu, si dhe paragjykimi, i cili vjen nga të tjerët", kishte thënë Ibrahim për Radion Evropa e Lirë.

Efektet negative që sjell izolimi i të rinjve në një kohë të rëndësishme për zhvillimin e tyre, si në adoleshencë, bëjnë që organizata amerikane Juvenile Law Center të kërkojë zhdukjen e institucioneve të tilla për të mitur.

Kate Burdick, avokate në këtë organizatë, thotë për Radion Evropa e Lirë se izolimi, kontrolli i vazhdueshëm dhe shkëputja nga mbështetja familjare ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin emocional të të rinjve. "Po flasim për fëmijë dhe të rinj, truri i të cilëve ende është në zhvillim. Kjo është një periudhë kur ata kanë nevojë për mbështetje, jo për trauma shtesë", thotë Burdick. Sipas saj, edhe në institucionet ku nuk ka dhunë fizike, vetë ndarja nga familja dhe komuniteti është problematike. "Ata trajtohen si numra dhe shkëputen nga njerëzit që përbëjnë identitetin dhe mbështetjen e tyre", thotë Burdick. "Pyetjet që dëgjojmë më shpesh janë: 'Si mund të flas më shumë me nënën time?' ose 'Si mund të mos e humbas

ditëlindjen e motrës?'". Sipas saj, alternativa më efektive janë programet komunitare, mentorimi, terapia dhe drejtësia restauruese. "Kërkimet tregojnë se alternativat ndaj burgimit janë më efektive në uljen e recidivizmit sesa izolimi i të rinjve në institucione", thotë Burdick.

Kosova nuk mban statistika për shkallën e recidivizmit në vend.

Sistemi më shumë ndëshkues sesa parandalues?

Sipas Donika Gashit, në letër, Kosova ka politika parandaluese. Por, në realitet, thotë ajo, sistemi vazhdon të funksionojë ndryshe. "Kjo do të thotë se institucionet aktivizohen pasi dëmi ka ndodhur: policia, prokuroria, gjykata dhe më pas sistemi korrektues", thotë ajo. Parandalimi i vërtetë, sipas Gashit, duhet të ndodhë shumë më herët: në shkollë, familje, qendra për punë sociale dhe shërbime të shëndetit mendor. "Duhet të kalojmë nga logjika 'ta dënojmë' te logjika 'ta ndërpresim ciklin'", thotë Gashi. Ajo argumenton se për veprat më pak të rënda, sidomos për kryesit për herë të parë, duhet të përdoren më shumë masa alternative, si puna në dobi të komunitetit, trajtimi i varësive dhe kthimi në arsim. "Drejtësia nuk përfundon me shqiptimin e

dënimit, por me sigurimin që personi të mos e përsërisë më të njëjtën vepër", thotë ajo.

Gashi thotë se një nga problemet kryesore mbetet mungesa e mbështetjes pas lirimimit. Sipas saj, rehabilitimi nuk duhet të kufizohet në trajnime brenda burgut. "Duhet të ketë lidhje reale me tregun e punës, mentorim dhe mbështetje psikologjike", sipas saj.

Ajo paralajmëron se, në të kundërtën, burgu rrezikon të forcojë "identitetin kriminal" të të rinjve.

"Parandalimi është më i lirë se burgimi"

Për ekspertët, investimi në arsim, punësim dhe shërbime komunitare shihet si mënyra më efektive për të ulur recidivizmin. Edhe Burdick argumenton se resurset financiare mund të përdoren më mirë jashtë institucioneve të mbyllura. "Është shumë më efektive dhe më pak e kushtueshme që mbështetja t'u ofrohet të rinjve në komunitet sesa në burg", thotë ajo.

Për Murselin, shifrat duhet të shërbejnë si alarm për institucionet. Ai paralajmëron se, pa politika afatgjate dhe investime serioze në rininë, problemet mund të thellohen. "Nëse vazhdojmë kështu, do të kemi probleme edhe më të mëdha në të ardhmen", përfundon Murseli.

LDK, Partia e Drejtësisë dhe Balli Kombëtar, bashkë në garën zgjedhore



PRISHTINË, 12 MAJ - Partia e Drejtësisë ka arritur marrëveshje bashkëpunimi politik me Lidhjen Demokratike të Kosovës për zgjedhjet e 7 qershorit 2026, duke e cilësuar këtë zhvillim hap të rëndësishëm drejt forcimit të stabilitetit politik dhe rikthimit të besimit qytetar në institucionet e Republikës së Kosovës.

Në komunikatën për medie, Partia e Drejtësisë thekson se kjo marrëveshje nuk përfaqëson vetëm një bashkim

elektoral, por një angazhim të përbashkët për rritjen e bashkëpunimit politik, dialogut institucional dhe përgjegjësisë shtetërore në vend. "Ky nuk është vetëm një bashkim elektoral, por një angazhim për krijimin e një fryme të re bashkëpunimi politik, dialogu institucional dhe mobilizimi të potencialeve më të mira profesionale e kombëtare në shërbim të qytetarëve dhe të shtetit", thuhet në komunikatën e PD-së.

Ndërkaq LDK ka njoftuar se Partia e Drejtësisë dhe Balli Kombëtar do të jenë në listën e Lidhjes Demokratike të Kosovës. "Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës Lumir Abdixhiku, ka nënshkruar marrëveshje parazgjedhore me Partinë e Drejtësisë dhe Ballin Kombëtar, për të garantuar së bashku në zgjedhjet e 7 qershorit. Partia e Drejtësisë do të garojë në listë me Ferid Aganin. Përderisa Balli Kombëtar me Alban Hotin", thuhet në njoftimin e LDK-së.

DERI NË VITIN 2030 KOSOVA SYNON TA ULË PAPUNËSINË E GRAVE DHE TA RRIKË PJESËMARRJEN E TYRE NË PUNË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 MAJ - Drejtoresha ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit, Edi Gusia, po merr pjesë në Forumin për Ekonominë e Kujdesit në Evropë dhe Azi Qendrore 2026, i organizuar nga UN Women Europe and Central Asia në Stamboll të Turqisë.

Pjesëmarrja e Kosovës në këtë forum të nivelit të lartë riafirmonte përkushtimin institucional të Qeverisë së Republikës së Kosovës për avancimin e barazisë gjinore dhe ndërtimin e politikave të qëndrueshme të ekonomisë së kujdesit si komponent kyç i zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Në kuadër të Forumit, Gusia kontribuoi në diskutimet strategjike mbi ekonominë e kujdesit, përfshirë panelin për lokalizimin e agjendës së kujdesit dhe takimin e mbyllur me delegacionet qeveritare lidhur me Planin Udhëzues për zhvillimin dhe zbatimin e Agjendës së Veprimit për Kujdesin 2026-2030.

Gjatë diskutimeve u theksua qasja proaktive e Kosovës në

integrimin e çështjeve të kujdesit në politikat publike dhe në prioritetet kombëtare për barazi gjinore dhe zhvillim ekonomik gjithëpërfshirës, përfshirë avancimin e kornizës ligjore përmes miratimit të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare. Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të avancojë politika që synojnë fuqizimin ekonomik të grave, rritjen e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës dhe krijimin e mekanizmave mbështetës që adresojnë barrën disproporcionale të punës së papaguar të kujdesit.

Në këtë drejtim, institucionet e Kosovës kanë shtuar përpjekjet për forcimin e kornizës ligjore dhe institucionale, zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si dhe zgjerimin e masave aktive të punësimit dhe shërbimeve sociale për gratë dhe grupet në nevojë.

Për periudhën 2026-2030 Kosova është zotuar për veprime konkrete dhe të matshme në tri fusha prioritare: rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës përmes programeve të synuara të punësimit dhe ndërmarrjes; zgjerimin e qasjes së grave dhe



vajzave në arsim dhe aftësim në fushat digjitale dhe STEM; si dhe forcimin e zbatimit institucional të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha institucionet e nivelit qendror. Deri në vitin 2030 Kosova synon ta shkurtojë më tej papunësinë e grave dhe ta rrisë pjesëmarrjen e tyre në fuqinë punëtore përmes politikave gjithëpërfshirëse të punësimit, zhvillimit të aftësive dhe mbështetjes për bizneset e

udhëhequra nga gratë. Gjatë Forumit u theksua se investimi në ekonominë e kujdesit, krahas së qenit çështje e barazisë sociale, është edhe investim strategjik për zhvillimin ekonomik, rritjen e punësimit, mirëqenien familjare dhe kohezionin shoqëror. Në këtë kuadër, Kosova mbetet e përkushtuar për të bashkëpunuar ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe organizatat

rajonale për ta përsheptuar përparimin drejt barazisë substanciale gjinore dhe zhvillimit gjithëpërfshirës. Forumi shërbeu gjithashtu si platformë e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave rajonale, forcimin e partneriteteve dhe koordinimin e angazhimeve të përbashkëta për zhvillimin e sistemeve të integruara dhe të qëndrueshme të kujdesit në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore.

KALLASI: ZGJEDHJET NË KOSOVË VONOJNË DIALOGUN PRISHTINË - BEOGRAD

PRISHTINË, 12 MAJ - Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, konfirmoi se ciklet e shpeshta zgjedhore në Kosovë janë arsyeja kryesore përse, prej kohësh, nuk ka pasur një raund të ri dialogu në mes të Prishtinës dhe Beogradit në nivel liderësh.

Ajo u tha gazetarëve se ka gatishmëri si nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ashtu edhe nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, për një takim në kuadër të dialogut, por se shpallja e zgjedhjeve të reja të parakohshme në Kosovë e ka shtyrë sërish procesin. "Ne, në fakt, kishim planifikuar dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës - dialog politik në nivel të lartë. Kishim pëlqimin e të dy liderëve - nga Kosova dhe nga Serbia - por tani po afrohen sërish zgjedhjet në Kosovë, gjë që natyrisht e shtyn procesin", tha Kallas. "Unë, megjithatë, po punoj veç e veç me të dyja palët që të mund të vazhdojmë me zbatimin e marrëveshjeve që tashmë janë në fuqi", shtoi ajo.

Udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë janë takuar për herë të fundit në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në shtator të vitit 2023.

Kallasi e mori detyrën e përfaqësueses së lartë të BE-së në



dhjetor të vitit 2024 dhe deri më tani nuk ka pasur rast të jetë nikoqire e ndonjë raundi bisedimesh. Ajo mirëpriti një takim të ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe homologëve të tyre nga Ballkani Perëndimor.

Para fillimit të takimit, ministri në detyrë i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës i Kosovës, Glauk Konjufca, tha se Kosova kërkon trajtim të barabartë dhe të drejtë nga Bashkimi Evropian, duke theksuar se vendi është i gatshëm

të avancojë në procesin e integritetit mbi bazë të meritave. Sa i përket dialogut me Serbinë, ai tha se procesi duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë.

Homologu i tij serb, Marko Gjuriq, tha më vonë se, në mëngjesin e punës, u diskutua për çështjen e dialogut dhe u kujtua fakti se Asociacioni i komunave me shumicë serbe në Kosovë nuk është formuar ende, edhe pse ishte një detyrim i nënshkruar në Bruksel.

Gjuriqi tha se përfaqësuesit e Kosovës janë përpjekur ta fajësojnë Serbinë për probleme të ndryshme rajonale dhe e kanë portretizuar vazhdimisht atë si burim të paqëndrueshmërisë. Ai shtoi se realizimi i propozimit të presidentit serb, Aleksandar Vuçiq, për ta pranuar gjithë Ballkanin Perëndimor në BE, menjëherë dhe pa vonesa, do të ishte hapi më i mirë i mundshëm si për Evropën, ashtu edhe për Ballkanin. "Vetëm imagjinoni sa më të

ulëta do të ishin tensionet në rajon, nëse të gjithë serbët, të gjithë shqiptarët, të gjithë boshnjakët do të mund të lëviznin lirshëm pa kufij, duke respektuar sovranitetin, shtetësinë, ligjet sigurisht, por pa pengesa burokratike", tha Gjuriqi. Sipas tij, mesazhi i Serbisë ishte që zona e lëvizjes së lirë, Schengen, të hapet për të gjithë rajonin sa më shpejt që të jetë e mundur. "Është frustruese që kemi kufij të fortë çdo 150 dhe 200 km", tha ai.

Bisedimet mes 27 shefave të diplomacive evropiane dhe gjashtë ministrave të Jashtëm të vendeve të rajonit pritet të shërbejnë si hyrje për një debat të mëtejshëm mbi situatën në rajon, i cili do të zhvillohet po sot, por vetëm në nivel të ministrave të BE-së.

Pritet që në takim të flitet edhe për përgatitjet e samitit BE - Ballkani Perëndimor që do të mbahet në qershor në Tivat të Malit të Zi. Sipas diplomatëve evropianë, fokusi kryesor do të jetë: forcimi i bashkëpunimit mes BE-së dhe rajonit, rritja e qëndrueshmërisë ndaj ndikimeve të jashtme, përafrimi me politikën e jashtme të BE-së, si dhe përmirësimi i marrëdhënieve mes vendeve të rajonit.

NGA BERLINI, THIRRJE PËR KOSOVËN DHE RAJONIN: MË SHUMË BASHKËPUNIM PËR PUNËSIM DHE ZHVILLIM

BERLIN, 12 MAJ - Sekretari i përgjithshëm i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Amer Kapetanović, mori pjesë në konferencën "Ballkani Perëndimor: avancimi i punësimit dhe politikave sociale së bashku", e mbajtur në Berlin në kuadër të Procesit të Berlinit, me fokus në forcimin e bashkëpunimit në fushën e punësimit dhe politikave sociale në Ballkanin Perëndimor. Konferenca u organizua nga Ministria Federale e Punës dhe Çështjeve Sociale e Gjermanisë, ndërsa fjalët hyrëse u mbajtën nga Barbel Bas, ministre Federale e Punës dhe Çështjeve Sociale; Naida Nishiç, ministre e Punës, Punësimit dhe Dialogut Social të Malit të Zi, në emër të kryesimit të Procesit të Berlinit 2026; si dhe Rokana Minzatu, zëvendës-presidente ekzekutive e Komisionit Evropian, përmes një video-mesazhi. Kapetanović foli në panelin "Promovimi i punësimit: strategji efektive për tregje pune të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse" së bashku me Delina Ibrahimaj, ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit; Besar Durmishi, ministër i Ekonomisë dhe Punës; dhe Jelena Vasić, këshilltare e lartë për Hartimin e Masave Aktive të Punësimit. Diskutimi u përqendrua në sfidat e përbashkëta të tregut të

punës në rajon, përfshirë mungesën e aftësive, informalitetin, presionet demografike, mobilitetin e fuqisë punëtore dhe nevojën për modernizimin e shërbimeve publike të punësimit. "Në të gjithë Ballkanin Perëndimor tregjet e punës përballen me rrethana të ndryshme, por shumë nga sfidat strukturore janë të përbashkëta. Mesatarisht, normat e punësimit dhe aktivitetit mbeten dukshëm nën nivelet e Bashkimit Evropian, papunësia e të rinjve dhe normat NEET vazhdojnë të jenë të larta, pjesëmarrja në mësimin gjatë gjithë jetës mbetet e kufizuar, ndërsa informaliteti vazhdon të dobësojë produktivitetin, të ardhurat publike dhe qasjen në mbrojtje sociale. Për këtë arsye bashkëpunimi rajonal nuk është një punë shtesë, por një domosdoshmëri praktike. Procesi i Berlinit jep drejtimin politik, Plani i Punës përcakton prioritetet konkrete, ndërsa roli i RCC-së është të ndihmojë në zbatimin e tyre përmes analizave, shkëmbimit të përvojave, monitorimit dhe mjeteve praktike që forcojnë institucionet dhe sjellin rezultate për qytetarët" tha Kapetanović. Duke folur për kontributin e RCC-së në fushën e punësimit dhe politikës sociale, Kapetanović theksoi rolin e Platformës për Punësim dhe



Çështje Sociale (ESAP) në mbështetjen e partnerëve të Ballkanit Perëndimor përmes analizave rajonale, harmonizimit me standardet e BE-së dhe mekanizmave praktikë si vlerësimi krahasues i Shërbimeve Publike të Punësimit dhe Projektet e Ndihmës së Ndërsjellë për Luftimin e punës së padeklaruar. Këto mekanizma u mundësojnë shërbimeve të punësimit, inspektorateve të punës, administratave tatimore dhe ministrive të krahasojnë performancën, të identifikojnë

boshllëqet, të shkëmbejnë përvoja dhe të kalojnë nga zotimet politike në përmirësime konkrete dhe të matshme. Konferenca shënoi gjithashtu prezantimin dhe nisjen zyrtare të Planit të Punës të Procesit të Berlinit për Punësim dhe Politikë Sociale, i cili synon forcimin e bashkëpunimit në fusha si mobiliteti i fuqisë punëtore, zhvillimi i aftësive, modernizimi i shërbimeve të punësimit dhe harmonizimi më i afërt me sistemet e Bashkimit Evropian. Kapetanović tha më tej se rajoni nuk i mungojnë strategjitë apo

zotimet, por zbatimi më i fuqishëm, shtrirja më e gjerë dhe qëndrueshmëria në veprim. "Askush tjetër nuk do të ndërtojë tregje pune të qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor përveç autoriteteve të rajonit, duke punuar së bashku dhe për të mirën e qytetarëve të tyre. RCC do të vazhdojë ta mbështesë këtë punë duke lidhur bashkëpunimin rajonal me proceset e Bashkimit Evropian dhe duke ndihmuar që zotimet të sjellin rezultate të dukshme dhe të matshme", ka përfunduar Kapetanović.

PAS PROTESTËS SË FERMERËVE, QEVERIA SHTON KONTROLLET NË SEKTORIN E QUMËSHTIT

PRISHTINË, 12 MAJ - Ministri i Bujqësisë, Armend Muja, tha se autoritetet në Kosovë kanë identifikuar raste kur produkte të qumështit të shitura në treg nuk e pasqyrojnë saktë përbërjen e tyre, mes dyshimeve për përdorim të qumështit pluhur dhe vajit të palmës si zëvendësues të qumështit të freskët dhe yndyrave shtazore. Në një konferencë për medie bashkë me përfaqësues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Muja tha se sektori i qumështit po përballlet me "presione të jashtme", duke përmendur rritjen e importeve të qumështit pluhur dhe vajit të palmës që, sipas tij, po ndikon drejtpërdrejt të fermerët vendorë. "Sektori i qumështit po përballlet me dy presione... tendenca për ta zëvendësuar qumështin e freskët me qumësht pluhur dhe tendenca për t'i zëvendësuar yndyrat shtazore me yndyra bimore, me vaj palme", tha Muja. Sipas tij, të dhënat e Doganës dhe



verifikimet e AUV-it tregojnë rritje të importeve të qumështit pluhur dhe fraksioneve të vajit të palmës që përdoren në industrinë e përpunimit të qumështit. Debati për sektorin e qumështit u nxit pas raportimit të Radios Evropa e Lirë se rreth 30 për qind e qumështit vendor po mbetet pa u shitur, ndërsa fermerët dhe përpunuesit fajësojnë importet dhe përdorimin e produkteve zëvendësuese për çrregullimet në treg.

Muja tha se gjatë javës së parë të kontroleve janë marrë 118 mostra në kufi dhe 52 mostra në tregun vendor, ndërsa analizat laboratorike kanë identifikuar raste të mospërputhjes. "Ani pse produktet mund të paraqiten si me përbërje qumështi, pas analizave ato rezultojnë që kanë përbërje tjetër", tha ai. Sipas ministrit, një pjesë e ngarkesave të importuara janë ndaluar përkohësisht në kufi dhe disa prej tyre janë kthyer mbrapsht për shkak të mospërputhjes me standardet dhe legjislacionin në

fuqi. Ai tha se qëllimi i masave të reja është garantimi i sigurisë ushqimore dhe rritja e transparencës për konsumatorët. "Konsumatori ka të drejtë të dijë çfarë po blen dhe çfarë po ha", tha Muja. Ministri njoftoi se qeveria do të publikojë dy vendime të reja për sektorin e qumështit. Njëri parasheh klasifikim më të saktë të produkteve të qumështit, ndërsa tjetri krijimin e një sistemi të ndarë prodhimi për produktet që përmbajnë qumësht pluhur dhe vaj palme. Sipas tij, emërtimet tradicionale si "qumësht", "djathë", "gjizë" apo "krem" do të mund të përdoren vetëm për produktet me përbërje nga yndyrat shtazore. "Në momentin kur shtohen [përbërës të tjerë], nuk vlej më këto emërtime tradicionale", tha Muja. Ai shtoi se operatorët ekonomikë që përdorin vaj palme dhe qumësht pluhur do të duhet të riaplikojnë për licenca të veçanta dhe

produktet e tyre nuk do të mund të tregohen me emërtime tradicionale të produkteve të qumështit. Sipas Mujës, me këto vendime pezullohet përdorimi i vajit të palmës dhe qumështit pluhur në përpunimin e produkteve të qumështit deri në krijimin e një kuadri të ri rregullativ nga AUV-i. Konferenca u mbajt disa ditë pasi fermerët protestuan duke hedhur qumështin në lumë në shenjë pakënaqësie për rënien e çmimit të grumbullimit dhe vështirësitë në treg.

Vaji i palmës në tregun e Kosovës

Përdorimi i vajit të palmës në Kosovë ka shënuar luhatje vitet e fundit. Të dhënat tregojnë rritje të ndjeshme në vitin 2022, ndjekur nga një rënie e lehtë në periudhën pasuese. Vaji i palmës përdoret kryesisht në industrinë ushqimore, veçanërisht në produkte të përpunuara.

ÇFARË DO TË THOTË SHPËRTHIMI I HANTAVIRUSIT PËR SHËNDETIN GLOBAL



Pamja e njerëzve të veshur me kostume mbrojtëse po rikthen kujtime jo fort të largëta për Katie Rosseinsky, e cila shqyrton më nga afër dallimet mes kësaj sëmundjeje dhe armikut tonë tashmë të njohur, Covid-19.

Gjatë ditëve të fundit, pothuajse të gjithë ata që njoh kanë përjetuar një ndjesi të pakëndshme déjà vu-je. Shprehje si “virus zoonotik”, “kontakt nga njeriu te njeriu”, “gjurmim dhe identifikim kontaktesh” apo “vetëizolim” po dëgjohej gjithnjë e më shpesh. OBSH po publikon deklarata të rregullta.

Ndjesia është çuditërisht e ngjashme me vitin 2020.

Vetëm se këtë herë, në vend të koronavirusit, titujt kryesorë dominohen nga Hantavirusi. Vëmendja nuk është më te resortet e skive në Itali, por te një anije turistike holandeze, MV Hondius. Tetë raste të kësaj sëmundjeje, që transmetohet nga brejtësit, janë lidhur tashmë me anijen, ndërsa pesë prej tyre janë konfirmuar në laborator. Deri tani janë regjistruar tre viktima, që nga nisja e anijes nga Argjentina në fillim të prillit.

Fotografite e personelit shëndetësor të veshur me kostume hermetike dhe pajisje të plota mbrojtëse, ndërsa evakujnë pasagjerë me simptoma të dyshuara, si edhe lajmi se dy britanikë po vetëizolohen në shtëpi pas ekspozimit të mundshëm në anije, po rikthejnë kujtime të fshehura nga fillimi i pandemisë. Po kështu edhe hartat e

pafundme që ndjekin lëvizjet e anijes, apo diskutimet jashtëzakonisht të detajuara në rrjetet sociale nga “epidemiologë të kolltukut”.

Është e kuptueshme që ky shpërthim po rikthen këto kujtime të padëshiruara, bashkë me një ankth të qetë, por të brendshëm.

Edhe pse mund të na pëlqejë të besojmë se pandemia e COVID-19 tashmë i përket së shkuarës, shumë prej nesh ende përballen me pasojat psikologjike të saj. Dhe çdo përmendje e një sëmundjeje të re zoonotike, pra një sëmundjeje që kalon nga kafshët te njerëzit, ngjall në mënyrë të pashmangshme frikën e një pandemie tjetër.

Që pas Covid-it, duket sikur jemi të gjithë në një gjendje alarmi të vazhdueshëm për “sëmundjen e radhës”. Një reagim i ngjashëm u pa edhe më herët këtë vit gjatë shpërthimit të meningjitit në Kent, kur farmacitë raportuan mungesë vaksinash për shkak të kërkesës së lartë.

Por, përpara se të nxitojmë të blejmë sërish letër higjienike me shumicë, sa duhet të shqetësohemi realisht për hantavirusin?

Ndërsa ka ende shumë pyetje rreth shpërthimit në anije, një gjë është bërë shumë e qartë nga autoritetet shëndetësore: pavarësisht ngjashmërive emocionale, kjo është një situatë shumë ndryshe nga ajo që pamë gjashtë vite më parë me Covid-in. Rreziku për publikun e gjerë mbetet shumë i ulët.

Çfarë është dhe a duhet të kemi frikë prej hantavirusit?

Hantavirusi përfaqëson një grup virusesh që mbarten nga brejtës si minjtë dhe zakonisht transmetohen përmes kontaktit me urinën ose feçetë e tyre. Kjo ndodh shpesh kur njerëzit pastrojnë jashtëqitjet e brejtësve dhe grimcat ngrihen në ajër, duke u thithur pa dashje. Virus mund të transmetohet gjithashtu përmes kafshimeve, plagëve të hapura ose kontaktit me sytë. Mendohet se çdo vit regjistrohen rreth 150,000 raste në botë, dhe më shumë se gjysma ndodhin zakonisht në Kinë.

Këto viruse ndahen në dy kategori kryesore, të cilat shkaktojnë sëmundje serioze, megjithëse të dyja fillojnë me simptoma të ngjashme me gripin: temperaturë, dhimbje muskujsh, dhimbje koke dhe marramendje. Hantaviruset e dikurshme: Më të zakonshme në Azi dhe Evropë, këto viruse mund të shkaktojnë ethe hemorragjike me sindromë renale (HFRS). Simptomat zakonisht shfaqen një deri në dy javë pas ekspozimit dhe mund të çojnë në insuficiencë të rëndë renale. Norma e vdekshmërisë varion nga 1 deri në 15 për qind. Hantaviruset e reja: Më të zakonshme në Amerikë, këto mund të shkaktojnë sindromën pulmonare të hantavirusit (HPS). Periudha e inkubacionit është më e gjatë, nga një deri në tetë javë, dhe sëmundja mund të shkaktojë

grumbullim lëngjesh në mushkëri dhe në kraharor, duke sjellë probleme serioze të zemrës dhe frymëmarrjes. Në këtë formë, shkalla e vdekshmërisë mund të arrijë afro 40 për qind.

Aktualisht nuk ekzistojnë vakcina apo trajtime specifike për asnjë nga format e infeksionit. Pacientët me raste të rënda mund të kenë nevojë për kujdes intensiv, mbështetje respiratore ose dializë. Në shumicën e rasteve, hantavirusi konsiderohet një “infeksion pa dalje”, që do të thotë se një person i infektuar zakonisht nuk ia transmeton virusin të tjerëve.

Ekziston vetëm një variant i njohur që mund të transmetohet nga njeriu te njeriu: virusi Andes, i gjetur kryesisht në Argjentinë dhe Kili.

Në vitin 1996, një shpërthim i këtij varianti nisi në qytetin El Bolsón në Argjentinë dhe më pas u përhap në qytete të tjera, duke përfshirë 16 raste të lidhura epidemiologjikisht.

Një tjetër shpërthim më i madh ndodhi në vitin 2018 në fshatin Epuyén, kur një burrë i infektuar mori pjesë në një festë ditëlindjeje menjëherë pasi ishte ekspozuar ndaj virusit. Më pas, disa nga personat që kishin qëndruar pranë tij e përhapën më tej sëmundjen në evente të tjera të mbushura me njerëz. Bilanci përfundimtar ishte 34 të infektuar dhe 11 viktima.

Pacientët në MV Hondius kanë rezultuar pozitivë pikërisht për variantin Andes, ndërsa ekzistojnë spekulime të

pakonfirmuara se shpërthimi mund të ketë nisur pas një ekspedite vrojtimi shpendësh pranë një zone mbetjesh në Ushuaia, në skajin jugor të Argjentinës.

Megjithatë, ekspertët theksojnë se edhe ky variant transmetohet vetëm përmes kontaktit shumë të afërt. “Nuk po flasim për kontakt rastësor nga larg,” ka deklaruar së fundmi Dr. Maria Van Kerkhove nga World Health Organization.

Ndërsa profesor Robin May nga UK Health Security Agency ka theksuar se “një kalim i shpejtë pranë dikujt në aeroport nuk ju vendos në rrezik.” Për publikun e gjerë, rreziku mbetet praktikisht i papërfillshëm.

Në fakt, shumica e shkencëtarëve bien dakord se hantavirusi nuk transmetohet mjaftueshëm në mënyrë efektive nga njeriu te njeriu për t’u shndërruar në pandemi.

Edhe në një ambient kaq të mbyllur si një anije turistike, ku pasagjerët ndajnë vazhdimisht hapësira dhe kontakte, numri i të infektuarve mbetet i kufizuar.

Viruseve mund t’u ndodhin mutacione, por ekspertët besojnë se hantavirusi do të duhej të pësonte ndryshime të mëdha evolucionare për t’u bërë një kërcënim real global.

Pra, nëse fjalë si “gjurmim”, “izolim” apo “transmetim në ajër” ju shkaktojnë ankth që nga koha e pandemisë, ekspertët janë pothuajse unanimitë: Një skenar “Covid 2.0” me hantavirusin është, të paktën për momentin, shumë i pamundur. / bota.al

NATO | PAKTI QË FORMËSOI PERËNDIMIN PO KALON NJË KRIZË IDENTITETI



NATO është “aleanca më efektive në botë”, tha dje kryeministri britanik. Që Aleanca Atlantike është “aleanca ushtarake më e suksesshme në histori” (Hillary Clinton, 2016) është një frazë e përdorur shpesh. E përsëritur shumë herë, rrezikon të humbasë vlerën. Por është e vërtetë, flasin faktet. Dhe dje kjo ishte plotësisht e justifikuar.

Në fakt, Keir Starmer po i përgjigjej Donald Trumpit, i cili sapo ishte shprehur se “nuk ka qenë kurrë i bindur për NATO-n... një tigër prej letre dhe këtë e di edhe Putini”. Historia e aleancës, tetëdhjetë e tetë vjet pas firmosjes që përkujtohet pasnesër, tregon pikërisht të kundërtën.

Roli vendimtar i NATO-s në Luftën e Ftohtë

Historia tregon se NATO luajti një rol thelbësor në Luftën e Ftohtë mes SHBA-së dhe BRSS-së, e cila përfundoi jo me një fitore ushtarake, por me një triumf politik dhe kulturor amerikan dhe perëndimor, pavarësisht nëse presidenti aktual i SHBA-së e pranon apo jo. Dhe se Vladimir Putini, ashtu si paraardhësit e tij sovjetikë që nga Joseph Stalini e tutje, me përjashtim të Mikhail

Gorbachevit dhe Boris Yeltsinit që gjetën një modus vivendi, mezi pret të çlirohet prej saj. Një botë pa NATO është ëndrra e ndjekur me këmbëngulje nga banorët e Kremlinit.

NATO dhe Italia: dalja nga izolimi

Historia thotë diçka tjetër specifike për Italinë: hyrja në NATO si anëtare themeluese në vitin 1949, vetëm katër vjet pas Çlirimit (25 prill 1945), tre vjet pas referendumit republikë-monarki (2-3 qershor 1946), dhe një vit e gjysmë pas miratimit të Kushtetutës (22 dhjetor 1947), ishte pasaporta që e nxori “Italinë e humbjes” nga izolimi ndërkombëtar.

Italia duhej të priste deri në vitin 1955 për Konferencën e Mesinas mbi integrimin europian dhe për hyrjen në OKB. Por të qenit në NATO që nga viti 1949 e kishte bërë tashmë një vend të respektueshëm dhe të respektuar në arenën ndërkombëtare.

Rrënjët strategjike të Aleancës

Dje, Starmer jo vetëm që iu përgjigj një tjetër sulmi të

Trumpit, me tone disi koloniale “shkoni merrni vetë naftën tuaj”, por u lidh idealisht me klimën strategjike në të cilën lindën rrënjët e Aleancës.

Bëhet fjalë për fjalimin e 5 marsit 1946 të Winston Churchillit mbi “perden e hekurt... nga Stettini në Baltik deri në Trieste në Adriatik”. Në atë moment ishim tashmë brenda kufijve të një aleance ende për t’u konceptuar dhe lindur.

Ky fjalim nuk u mbajt në Londër apo Paris, por në Fulton, Missouri, në zemër të Amerikës. Churchill i kuptonte se ndarja ideologjike dhe fizike e Europës kërkonte një aleancë të qëndrueshme përtej Atlantikut. Në tavolinat e Uashingtonit ishte ende i freskët “telegrami i gjatë” i 22 shkurtit 1946 i George Kennanit, nga i cili lindi doktrina e “frenimit” të ekspansionizmit sovjetik. Europeanët e raskapitur nuk mund të mbroheshin vetëm. As SHBA nuk mund ta përmbante BRSS pa Europën. Duhej një siguri e përbashkët. NATO lindi pikërisht nga kjo logjikë.

Themelimi i NATO-s dhe tri intuitat kyçe

Më 4 prill 1949, SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Franca,

Belgjika, Holanda, Luksemburgu, Portugalia, Italia, Norvegjia, Islanda dhe Danimarka firmosën Traktatin e Uashingtonit, i cili hyri në fuqi më 24 gusht, me ratifikime rekord.

Aleancat nuk janë risi historike. Por NATO bashkon tre intuita të rralla:

Së pari, integrimi i dimensionit ushtarak me atë politik: një aleancë politiko-ushtarake ku vendimet merren në një forum politik.

Së dyti, lidhja gjeopolitike mbrojtëse mes Amerikës së Veriut dhe Europës për të frenuar Bashkimin Sovjetik, duke kërkuar që amerikanët të “qëndrojnë” në Europë.

Së treti, themelimi mbi vlera të përbashkëta: demokracia, liritë individuale dhe shteti i së drejtës. Formula e famshme ishte: “mbani amerikanët brenda, rusët jashtë, gjermanët poshtë”.

Nga Lufta e Ftohtë tek konfliktet moderne

Me zgjerimet dhe tejkalimin e krizave të brendshme e të jashtme, NATO arriti fundin e Luftës së Ftohtë mes vitit 1989 (rënia e Murit të Berlinit) dhe 1991 (shpërbërja e Traktatit të Varshavës).

Falë një angazhimi të fortë në


mbrojtje dhe parandalim, NATO arriti të kalojë Luftën e Ftohtë pa e kthyer atë në luftë të nxehtë. Më pas nis faza e dytë. Luftërat në ish-Jugosllavi treguan se NATO mbetej e nevojshme. Pas masakrave si ajo e Srebrenicës, ishte NATO që ndërhyri në Bosnje (1995) dhe në Kosovë (1999).

Më pas erdhi Afganistani (2003–2021), misioni më i gjatë i Aleancës, si akt solidariteti pas 11 shtatorit. Qëllimi ishte stabilizimi politik dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Fati mungoi, por jo vlera.

Zgjerimi dhe përplasja me Rusinë

Në të njëjtën kohë, NATO u zgjerua drejt Europës Lindore: Polonia, Çekia, Hungaria (1995), vendet baltike dhe Ballkani (2004–2009), Mali i Zi (2017), Maqedonia e Veriut (2020).

Ndërkohë, raportet me Rusinë u përkeqësuan: 2008: Georgia, 2014: Krimea, 2022: pushtimi i Ukrainës. Kjo çoi në hyrjen e Finlandës (2023) dhe Suedisë (2024), që kërkuar mbrojtje përfundimtare. A është NATO “tigër prej letre”? Vendet pranë Moskës nuk mendojnë kështu. / la stampa – bota.al



EURO GLASS
SAINT-DONAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kosova U14 nis aventurën në turneun e FIBA YDF në Rumani

PRISHTINË, 12 MAJ - Federata e Basketbollit e Kosovës ka bërë me dije se Kosova do të marrë pjesë në turneun e rëndësishëm ndërkombëtar FIBA Youth Development Fund Tournament, i cili nis

sot (e mërkurë) dhe përfundon më 17 maj. Në këtë garë do të paraqiten talentet e grupmohave U14 si në konkurrencën e djemve ashtu edhe të vajzave, të cilët synojnë ta përfaqësojnë

sa më mirë Kosovën në arenën ndërkombëtare. Sipas FBK-së, ky turne konsiderohet një mundësi shumë e rëndësishme për zhvillimin e basketbollistëve të rinj dhe fitimin e përvojës

në ndeshje ndërkombëtare. Federata ka njoftuar se orari i ndeshjeve, përbërjet e Kosovës dhe linku për transmetimin e takimeve janë publikuar në faqen zyrtare të saj.



FFK-JA ARANZHON DY NDESHJE MIQËSORE PËR KOMBËTAREN E KOSOVËS

PRISHTINË, 12 MAJ - Kombëtarja e Kosovës do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore gjatë muajit qershor në kuadër të përgatitjeve për edicionin e ri të Ligës së Kombeve që nis në shtator, e ku do të garojë në Ligën B. "Dardanët" fillimisht do të përballen me Kombëtaren e Çekisë më 31 maj në stadiumin "Epet Arena" në Pragë. Kjo ndeshje pritet të jetë test i rëndësishëm për ekipin e drejtuar nga përzgjedhësi Franco Foda përballë një kundërshtari cilësor evropian. Çekia e ka siguruar pjesëmarrjen në Botërorin 2026 pasi e

mposhti Danimarkën pas penaltive në "play-off"-in evropian, duke u rikthyer në Kupën e Botës për herë të parë që nga viti 2006. Aktualisht çekët renditen në pozitën e 41-të në ranglistën e FIFA-s. "Dardanët" janë përballur me Çekinë deri më tash dy herë në kuadër të kualifikimeve për Evropianin 2020. Në ndeshjen e parë më 7 shtator të vitit 2019, Kosova kishte fituar në "Fadil Vokrri", 2:1, ndërsa në ndeshjen e kthimit në Pzen pati pësuar humbje 2:1, më 14 nëntor, 2019. Ndeshjen e dytë miqësore Kosova do ta zhvillojë më 7

qershor kundër Andorrës, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Edhe me Andorrën "Dardanët" janë ballafaqur dy herë në kuadër të kualifikimeve për Euro 2024. Kanë barazuar në Prishtinë (1:1) dhe kanë fituar në Andorra La Vella (3:0). Këto dy miqësore do t'i shërbejnë stafit teknik për ta vazhduar ndërtimin e skuadrës për ndeshjet e ardhshme me karakter garues në Ligën B, ku Kosova bën pjesë në Grupin B3 me Austrinë, Izraelin dhe Irlandën. "Dardanët" do të grumbullohen në hotel "Emerald" më 27 maj.



DRITA NË VAZON E EKIPEVE FAVORITE NË DY RRETHET E PARA TË LIGËS SË KAMPIONËVE

PRISHTINË, 12 MAJ - Sukseset e Dritës në arenën evropiane kanë filluar t'i japin frytet e veta. Kampioni i Kosovës ka bërë ngritje të madhe në ranglistën e UEFA-s për klube falë paraqitjeve të mira në sezonet e fundit në garat evropiane. Kampionët e rinj të Kosovës janë skuadra shqiptare më së larti në ranglistën e UEFA-s dhe me më së shumti pikë, pasi zënë vendin e 133-të me 13 625 pikë të grumbulluara. Paraqitjet pozitive në Ligën e Konferencës ku ka luajtur gjatë ndeshjeve në fazën e ligës dhe pastaj dy të tjera në "play-off" dhe grumbullimi i pikëve të vlefshme kanë bërë që Drita tashmë të jetë në vazhon e ekipeve favorite për dy rrethet e para kualifikuese të Ligës së Kampionëve për edicionin 2025/26.




Në rrethin e parë kualifikues Drita bën pjesë në mesin e skuadrave favorite së bashku me ekipe si Celje, Shamrock Rovers, KuPS, Lincoln Red Imps, Borac Banja Luka dhe Kairat. Kjo pozitë i mundëson klubit gjilanas të shmangë kundërshtarë më të fortë që në fazën e hershme të garës. Po ashtu, në rast të kalimit të raundit të parë, Drita do të jetë sërish në vazhon e ekipeve favorite edhe në rrethin e dytë kualifikues, ku potencialisht

mund të shmangë skuadra të njohura evropiane si Crvena Zvezda, Dinamo Zagreb dhe Slovan Bratislava. Kjo është hera e parë që një skuadër nga Kosova është favorite në dy raundet e para të Ligës së Kampionëve, pasi Drita është edhe skuadra e vetme e Kosovës që ka arritur të kalojë një raund të Ligës së Kampionëve. Ky është një tjetër tregues i rritjes së klubit bardhekalter në skenën ndërkombëtare dhe një shprehje të merituar për sukseset që Drita ka arritur vitet e fundit në Evropë. Në rast se kalon dy rrethet e Ligës së Kampionëve, atëherë Drita do t'i sigurojë automatikisht grupet e Ligës së Konferencës dhe do të kishte mundësi të luante në "play-off" të Ligës së Evropës. Qëllimi i gjilanasve është të futën në këtë të fundit.

DEMELE SHPALLET LOJTARI MË I MIRË NË FRANCË

PARIS, 12 - Me 10 gola dhe 6 asiste vetëm në Ligën 1, Ousmane Dembele është vlerësuar lojtari më i mirë i këtij sezoni në Francë. Ylli i PSG-së vazhdon të dominojë. Ai këtë vit ka shkëlqyer duke qenë përcaktues në ekipin e Luis Enrique. Falë paraqitjeve të tij, PSG-ja është vetëm një hap larg titullit në Francë, në të njëjtën kohë ka arritur të sigurojë edhe një vend në finalen e Ligës së Kampionëve ku në sfidën dyshe përballë Bayern Munich, Demele ka realizuar 3 nga 6 golat. Demele është shpallur lojtari më i mirë francez, ndërsa me çmim u vlerësua edhe Michael Olise. Sulmuesi i Bayern Munichut ka fituar trofeun e lojtarit më të mirë francez që luan jashtë vendit. Në këtë garë yjesh, Olise ka lënë pas Kylian Mbappen e Real Madridit dhe



Rayan Cherkhi të Man. City. Olise është duke zhvilluar një supersezon me fanellën e Bayern Munichut, ku ka dhënë kontribut në 50 gola në 52 ndeshje, me 20 gola dhe 30 asiste. Forma fantastike e Olise ka bërë që për yllin francez të shfaqin interesim shumë klube në Evropë, mbi të gjitha Real Madridi, por francezi ka fituar statusin si i paprekshëm në shtëpinë e Bayern Munichut.

Chelsea shpreh seriozisht interesim për Xabi Alonso

Londër, 12 maj - Chelsea është në "peshkim" për ta gjetur trajnerin e ri dhe një nga emrat kryesorë në listë është Xabi Alonso. Sipas gazetarit të njohur David Ornstein, klubi anglez po eksploron mundësinë për ta emëruar spanjollin si trajnerin e

ardhshëm, ndërsa Alonso thuhet se është i hapur ndaj këtij opsioni, megjithatë ende nuk është marrë një vendim përfundimtar. "Blutë" janë në kërkim të një zëvendësuesi të përhershëm për Liam Rosenior, i cili u shkarkua në prill pas më pak se katër muajsh në krye të

ekipit. Përveç Alonsos, në garë për stolin e Chelseat përmenden edhe Andoni Iraola, që pritet të largohet nga Bournemouthi si dhe trajneri i Fulhamit, Marco Silva. Xabi Alonso ka mbetur pa ekip që nga largimi nga Real Madridi në fillim të këtij viti. Më parë ai

ka drejtuar Bayer Leverkusenin drejt një titulli historik në Bundesligë në sezonin 2023/24, duke përfunduar kampionatin pa humbje. Skuadrën e Chelseas është duke e udhëhequr përkohësisht Calum McFarlane, i cili do të mbetet në detyrë deri në fund



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **“Pizzeria Bella Casa Mia” Sh.P.K.** me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812384585 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa **“Pizzeria Bella Casa Mia” D.O.O.** od Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812384585 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability **“Pizzeria Bella Casa Mia” L.L.C.** with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812384585 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **“Furra Piceria Edi” SH.P.K.** pronar Shaqir Duraj me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812396069 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa **“Furra Piceria Edi” D.O.O.** Shaqir Duraj Vushtrri donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812396069 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability **“Furra Piceria Edi” L.L.C.** with owner Shaqir Duraj with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812396069 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **“Kosbit Group” L.L.C.** me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811385815 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa **“Kosbit Group” L.L.C.** Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811385815 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability **“Kosbit Group” L.L.C.** with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811385815 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Elza Bicurri B.I. D.P.T. “Charlie-N” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811146209.
- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.
- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 marsi” Prizren.
- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejta

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553



Prishtinë, 07.05.2026

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812109454 me adresë: Rr. „Mazllam Kastrati, Tranziti i Vjetër“ pn, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 14.04.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panellet solare me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës.

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.4363-2/25 dt. 18.08.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimin Nr. 04-353/01-21408 të dt. 07.03.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Aktvendimin nr. 04-353/01-135622 të dt. 10.10.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Nr.04-353/01-22408 dt. 19.03.2026, për “Vendosjen e paneleve solare fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 1 MW, ngastrata katastrale 00142-1 ZK Petrovë, gjegjësisht në objektin me nr. 24-0 ZK Petrovë, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 4131 dt. 24.03.2026 të lëshuar nga KEDS SLLA.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund të paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronikë: luan@ild-prizren.com, crzen.krasniqi@solar2.eu dhe LEGAL-LECCENSING@cro-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

